

Nr. ____ Prot.

Berat, me ____/____2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 1.12.2020

Për: BOE: “AZ TRADING” sh.p.k me NIPT: L81515016F, adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla G&P, Kati 1, Tirane & “ARKONSTUDIO” sh.p.k me NIPT: L42019004I, me adrese: Rruga “Mihal Duri”, Objekti Nr.33, Tirane.

Procedura e prokurimit: E hapur- Pune

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72653-09-22-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndertimi i linjes TM 10 kV Fideri Bogove, per furnizimin e Teqese ne Tomorr dhe Energjizimi i N/Stacionit 110/35/10 kV Corovode” me fond limit: 27, 861, 623 (njezete e shtate milion e teteqind e gjashtedhete e nje mije e gjashteqind e njezete e tre) leke pa tvsh. Kohezgjatja eshte 6 muaj nga dorezimi I sheshit te nderitmit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): JO

Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] Nr. 77 datë 28 Shtator 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE: “Totila” sh.p.k, me NIPT: K13001010G , “Ed Konstruksion” sh.p.k me NIPT: K61625001I & “Beqiri” sh.p.k me NIPT: J98624801V

Vlera: 25,103,623 (njezete e pese milion e njeqind e tre mije e gjashteqind e njezete e tre) leke pa t.v.sh

2. BOE: “FLED” sh.p.k me nipt K17621104C & “SHKELQIMI 07” sh.p.k me nipt: K68121808W

Vlera: 24, 634, 737 (njezete e kater milion e gjashteqind e tridhete e kater mije e shtateqind e tridhete e shtate) leke pa t.v.sh

3. BOE: “ARKONSTUDIO” sh.p.k me nipt L42019004I & “AZ TRADING” sh.p.k me nipt: L81515016F

Vlera: 26,111,192 (njetete e gjashte milion e njeqind e njembedhjete mije e njeqind e netedhjete e dy) leke pa t.v.sh

4. “START CO” sh.p.k me nipt L11614001S

Vlera: 27,529,925.74 (njetete e shtate milion e peseqind e njetete e nente mije e nenteqind e njetete e pese pik shtatedhjete e kater) leke pa t.v.sh

5. “EN-EL” shpk me NIPT: L22405011A

Vlera: 0 (zero) leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE: “Totila” sh.p.k, me NIPT: K13001010G “Ed Konstruksion” sh.p.k me NIPT: K61625001I & “Beqiri” sh.p.k me NIPT: J98624801V

2. BOE: “FLED” sh.p.k me nipt K17621104C & “SHKELQIMI 07” sh.p.k me nipt: K68121808W

3. “START CO” sh.p.k me nipt L11614001S

4. “EN-EL” shpk me NIPT: L22405011A

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. BOE: “TOTILA” sh.p.k & “ED KONSTRUKSION” shpk, “BEQIRI” sh.p.k

Bashkimi I Operatoreve Ekonomik: “TOTILA – ED KONSTRUKSION – BEQIRI” me lider OE – TOTILA SHPK pjesmarrese ne proceduren “Ndertimi i linjes TM 10 kV Fideri Bogove, per furnizimin e Teqese ne Tomorr dhe Energjizimi i N/Stacionit 110/35/10 kV Corovode” nuk ploteson kriteret e meposhteme te kualifikimit:

1. Referuar pikes 2.3.6 te Kriteve te Vecanta te DST , OE TOTILA SHPK nuk ka ne stafin e tij Inxhinier Elektrik per te kryer punimet elektrike te cilat I ka marre persiper sipas % dhe zerave ne preventivin e ndarjes se punimeve bashkengjitur marreveshjes se bashkepunimit te operatoreve te lidhur para noterit me date 26.10.2020 me Nr.Rep 2954 dhe Nr.Kol 987.
2. BOE “TOTILA – ED KONSTRUKSION – BEQIRI” me lider OE – TOTILA SHPK nuk ka plotesuar shtojcen 1 te DST- Formulari I Ofertes Ekonomike sipas formularit te dhene nga AK ne DST, mungon vlera e ofertes e shprehur me fjale.
3. BOE “TOTILA – ED KONSTRUKSION – BEQIRI” me lider OE – TOTILA SHPK nuk ploteson piken 2.3.10 te Kriteve te Vecanta te DST pasi nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi/Distributori, Katalog dhe test raport per mallrat:
 - Kabell AL 10kV XLPE,
 - Ndares ngarkese
 - Shkarkues
 - Shtylla b/a
 - Percjelles ACSR
 - Elektroda tokezimi
 - Izolator TM 10kV,

sipas kontrates se bashkepunimit per furnizim me TEOREN. Nuk vertetohet lidhja mes TEOREN dhe prodhuesve. Nuk eshte paraqitur asnje dokument teknik i cili verteton lidhjen e OE Ofertues me prodhuesin githashtu nuk eshte paraqitur asnje katalog per mallrat e mesiperm per te vertetuar perputhshmerine e tyre me specifikimet teknike te publikuara nga AK.

4. BOE “TOTILA – ED KONSTRUKSION – BEQIRI” me lider OE – TOTILA SHPK nuk ploteson kriterin e pergjithshem: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe” pasi kataloget e paraqitur ne plotesim te kriterit 2.3.10 jane ne gjuhe te huaj dhe te pa perkthyer dhe noterizuar.

2. BOE: “FLED” sh.p.k & “SHKELQIMI 07” sh.p.k

Bashkimi I Operatoreve Ekonomik: “FLED SHPK & SHKELQIMI 07 SHPK ” me lider OE – FLED SHPK pjesmarrese ne proceduren “Ndertimi i linjes TM 10 kV Fideri Bogove, per furnizimin e Teqese ne Tomorr dhe Energjizimi i N/Stacionit 110/35/10 kV Corovode” nuk ploteson kriteret e meposhteme te kualifikimit:

1. OE FLED SHPK nuk ploteson kriterin 2.3.3 pasi nuk ka te perfshire objektin e procedures ne Certifikatat ISO te tij (9001,14001 dhe 45001). Objekti: Nderim godina civile, rruge , ujesjellesa dhe kanalizime nuk perputhet me objektin e procedures dhe rrjedhimisht ky OE nuk eshte I certifikuar sipas stadarveve ISO 9001,14001 dhe 45001 per te kryer keto punime.
2. BOE Bashkimi I Operatoreve Ekonomik: “FLED SHPK & SHKELQIMI 07 SHPK ” me lider OE – FLED SHPK nuk ploteson piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim pasi nuk ka paraqitur asnje dokument teknik per te permbushur kriterin I cili thote :

Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga te cilat specifikimet teknike te produkteve te kerkuara te jene ne gjuhen e ofertes.
- Katalog/skede teknike te prodhuesit ku te paraqiten specifikimet teknike te ofertuara
- Per zerat : Kabell AL 10kV XLPE, percjelles ACSR, Izolatore 10kV, Ndares 10kV, Shkarkues 10kV operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera nga fabrika ose nga pale te treta te certifikuara.

Ne kete rast AK nuk mund te verifikojë se mallrat e ofertuar nga ky OE permbushin te gjitha kriteret dhe specifikimet teknike te kerkuara ne dokumentat e tenderit. Nuk eshte percaktuar origjina, fabrika, karakteristikat teknike dhe testimet e meparshme te kryera qe vertetojne pajtueshmerine e ketyre mallrave me ato te kerkuara nga AK.

3. “START CO” sh.p.k

1. Nuk permbush kapacitetet teknike sipas pikes 2.3.9. Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates (Shtojca 10)
2. Nuk ploteson piken 2.3.10 te Kriterëve te Vecanta te DST pasi nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi/Distributori, Katalog dhe test raport per mallrat:
 - Kabell AL 10kV XLPE,
 - Ndares ngarkese
 - Shkarkues
 - Shtylla b/a
 - Percjelles ACSR

- Elektroda tokezimi
- Izolator TM 10kV,

sipas kontrates se bashkpunimit per furnizim me TEOREN. Nuk vertetohet lidhja mes TEOREN dhe prodhuesve. Nuk eshte paraqitur asnje dokument teknik i cili verteton lidhjen e OE Ofertues me prodhuesin githashtu nuk eshte paraqitur asnje katalog per mallrat e mesiperm per te vertetuar perputhshmerine e tyre me specifikimet teknike te publikuara nga AK.

4. “EN- EL” sh.p.k:

Ky operator ekonomik ka paraqitur si document vetem nje Formular Oferte pa vlere fare (bosh) dhe nje Ekstrakt Historik te regjistrimit themeltar.

Ne Dokumentat Standarte te Tenderit, ne shtojcen 12 eshte cituar: Rastet e mosparaqitjes ten je dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kusht per skualifikim.

Operatoret ekonomike janë te detyruar te përgatisin oferta ne përputhje me kërkesat e përcaktuara ne dokumentat e tenderit, ne menyre qe edhe vleresimi te behet ne perputhje me kete dokumentacion. Mosplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme.

Ne nenin 46 te ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 per “Prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin Nr.9800, date 10.09.2007, ligjin Nr.9855, date 26.12.2007, ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, dhe ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, ligjin nr.131 dt. 27.12.2012 dhe Ligjin Nr. 182/20141 parashikohet se “Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE: “AZ TRADING” sh.p.k me NIPT: L81515016F, adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla G&P, Kati 1, Tirane & “ARKONSTUDIO” sh.p.k me NIPT: L42019004I, me adrese: Rruga “Mihal Duri”, Objekti Nr.33, Tirane se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 26,111,192 (njetete e gjashte milion e njeqind e njembdhjete mije e njeqind e netedhjete e dy) leke pa t.v.sh]/pikët totale të marra [100] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtoria Rajonale e OSSH, Berat, me adrese Rr. “Antipatrea”, prane Gjykates, Berat sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do te anulohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.11.2020

Ankesa: JO

[Titullari i autoritetit kontraktor]